



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë nenit 3.1, pikat b dhe h, të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe nenit 19, par.1, pikat b dhe ë të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2006, merr

V E N D I M

PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE TË PALLATIT TË RINISË NË PRISHTINË NË BAZË TË KONTRATËS MBI KONCESIONIN

Neni 1

Miratohet Vendimi për realizimin e përmbajtjeve të Pallatit të Rinisë në Prishtinë në bazë të kontratës mbi koncesionin.

Neni 2

Realizimi i përmbajtjes, nga neni 1 i këtij Vendimi sipas kontratës mbi koncesionin, paraqet fazën e tretë të përcaktuar të Pallatit të Rinisë, me destinim për sport dhe rekreacion, garazh publik, afarizëm dhe përmbajtje tjera përcjellëse, në pjesën e ngastrës kadastrale 6191/2, Zona kadastrale Prishtinë.

Projekti ideor do të hartohet në bazë të kriterëve urbane, të përcaktuara nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë i Komunës së Prishtinës.

Projekti nga par.2 i këtij neni, do të inkorporohet në planin e ardhshëm rregullues të kompleksit të gjerë.

Neni 3

Realizimi i përmbajtjes së planifikuar sipas kontratës mbi koncesionin, do të bëhet përmes ofertave publike dhe procedurave tjera ligjore, të parapara për dhënie me koncesion.

Neni 4

Para nënshkrimit të kontratës me koncesionarin e zgjedhur sipas procedurës nga neni 3 i këtij Vendimi, kontratën do ta shqyrtojë dhe miratojë Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Për realizimin e përmbajtjes së planifikuar sipas këtij Vendimi dhe kushteve të përcaktuara me kontratën mbi koncesionin, do të kujdeset kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës përmes Bordit të drejtorëve.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 35-593, më 27.12.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri